

TERMAT DHE KUSHTET PËR PËRDORIMIN E SHËRBIMIT OPEN BANKING

Përkufizime:

- **Ofrues i Palës së Tretë (TPP – Third Party Provider):** Janë entitete që ofrojnë shërbime pagese pa mbajtur fondet e klientit.
- **Ofrues i Shërbimit të Inicimit të Pagesës (PISP – Payment Initiation Service Provider):** Është një ofrues i palës së tretë që mundëson pagesa direkte online nga llogaria bankare e klientit drejt një tregtari ose ofruesi shërbimi.
- **Ofrues i Shërbimit të Informacionit të Llogarisë (AISP – Account Information Service Provider):** Është një ofrues i palës së tretë i autorizuar për të aksesuar dhe marrë të dhëna financiare nga llogaria bankare e klientit, por pa kryer transaksione.
- **Përdorues i Shërbimit të Pagesave (PSU – Payment Service User):** I referohet çdo individ apo entiteti që përdor një shërbim pagese.
- **Ofrues i Shërbimit të Pagesave që Administron Llogarinë (i referuar si "Banka" ose "BKT"):** Është institucioni që ofron një ndërfaqe të dedikuar API, sipas nenit 35 të Rregullores nr. 29/2022 "Për autentikimin e fortë të klientit dhe standardet e përbashkëta, të hapura dhe të sigurta të komunikimit".
- **Ndërfaqe Programimi Aplikacionesh (API – Application Programming Interface):** Është një ndërfaqe e standardizuar që lejon TPP-të, PISP-të dhe AISP-të të aksesojnë në mënyrë të sigurt dhe të ndërveprojnë me informacionin e llogarive bankare të klientëve.
- **Përfitues i Pagesës (Payment Beneficiary):** I referohet individit apo entitetit që merr fondet nga një transaksion pagese.
- **SCA (Autentikim i Fortë i Klientit – Strong Customer Authentication):** I referohet metodës së autentikimit të klientit që aplikohet në të gjitha kanalet e open banking në përputhje me Rregulloren nr. 29/2022.
- **SLA (Marrëveshje për Nivelin e Shërbimit – Service Level Agreement):** Dokument që përcakton nivelin e shërbimit dhe standardet e rikuperimit të shërbimit.
- **Aplikuesi:** Të gjitha institucionet (TPP, PISP, AISP) që kërkojnë integrim me ndërfaqen API të ofruar nga BKT, në përputhje me kuadrin rregullator të Open Banking.
- **Palët:** I referohet bashkërisht bankës dhe aplikuesit.

Hyrje

Ky dokument përcakton termat dhe kushtet që rregullojnë aksesin dhe përdorimin e Shërbimit Open Banking të ofruar nga Banka Kombëtare Tregtare sh.a. (në vijim "BKT") nga palët e treta të autorizuara (Third Party Providers – TPP) si dhe nga klientët fundorë (Payment Service Users – PSU), në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 55/2020 "Për shërbimet e pagesave" dhe kuadrin rregullator të Bankës së Shqipërisë.

Përdorimi i këtij shërbimi kërkon dhënien e pëlqimit të shprehur dhe të informuar nga klienti për aksesimin e të dhënave të tij financiare ose për iniciimin e pagesave nëpërmjet aplikacioneve të palëve të treta të licencuara. Pëlqimi i dhënë nga klienti mund të revokohet në çdo kohë, pa cenuar ligjshmërinë e përpunimit të bërë përpara revokimit.

TPP-të janë të detyruara të jenë të pajisura me certifikata të kualifikuara (QWAC dhe/ose QSEAL) në përputhje me standardet e eIDAS dhe të kenë përfunduar procesin e integritetit dhe verifikimit teknik në ambientin sandbox të BKT-së përpara aksesit në ambientin e prodhimit.

Aplikuesi deklaron se është informuar dhe pranon që ky kanal shërbimi është i dedikuar për pagesa brenda territorit të Shqipërisë për të gjithë konsumatorët (përfshirë personat juridikë) dhe se aktivizimi i këtij shërbimi do të kryhet vetëm pas miratimit të kushteve të zbatueshme të përcaktuara në këtë dokument.

Akses në Portalin e Zhvilluesve të BKT-së

Portali i Zhvilluesve i BKT-së ofrohet në mënyrë diskrecionale nga Banka Kombëtare Tregtare dhe çdo individ apo entitet që dëshiron të përfitojë akses duhet të regjistrohet nëpërmjet faqes zyrtare të portalit. BKT rezervon të drejtën të shqyrtojë dhe miratojë ose refuzojë çdo aplikim për regjistrim sipas vlerësimit të saj të pavarur dhe do të informojë në mënyrë të përshtatshme për çdo refuzim, në përputhje me kuadrin ligjor.

Aplikuesi angazhohet të deklarojë çdo konflikt interesi aktual ose potencial që mund të lindë nga aplikimi për regjistrim në portal, përfshirë por jo kufizuar në raste kur subjekti është i punësuar apo i lidhur me një institucion tjetër financiar apo konkurrent të BKT-së.

Aplikuesi deklaron se ka marrë licencën përkatëse nga Banka e Shqipërisë ose ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit të parashikuar në nenin 99 të Ligjit nr. 55/2020 'Për Shërbimet e Pagesave' dhe do të paraqesë pranë BKT dokumentacionin përkatës që e vërteton këtë.

Aplikuesi deklaron se do të bashkëpunojë me bankën në ofrimin e informacionit apo dokumentacionit të nevojshëm (kur kërkohet) si pjesë e proceseve të vlerësimit të rrezikut gjatë fazës së aplikimit dhe integritit.

Të gjitha informacionet e dhëna gjatë procesit të regjistrimit duhet të jenë të sakta, të plota dhe të përditësuara. Aplikuesi është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe përditësimin e këtij informacioni gjatë gjithë kohëzgjatjes së regjistrimit të tij.

Në rast të regjistrimit të suksesshëm, përdoruesit mund t'u jepen kredenciale hyrjeje, fjalëkalime apo informacione të tjera identifikuese ("Kredencialet"), të cilat mbeten pronë e BKT-së dhe për të cilat i jepet një licencë e pakalueshme, e pa-transferueshme dhe me qëllim të vetëm përdorimit brenda Portalit të Zhvilluesve.

Përdoruesi është i detyruar të mbajë konfidencialitetin e këtyre kredencialeve dhe nuk lejohet t'i transferojë, shesë, nënlicencojë apo t'i zbulojë ato në asnjë mënyrë ndaj palëve të treta. Nëse përdoruesi dyshon ose ka dijeni se konfidencialiteti i kredencialeve është cenuar, ai duhet të informojë BKT-në pa vonesë të pajustificuar.

Ndalohet çdo përpjekje për të anashkaluar apo modifikuar kredencialet, sistemet e autentifikimit ose mekanizmat e sigurisë që përdoren nga BKT në lidhje me Portalin e Zhvilluesve.

Rregullat për përdorimin e Portalit të Zhvilluesve të BKT-së

Përdoruesi është përgjegjës për të gjitha veprimtaritë që realizohen përmes përdorimit të Kredencialeve të tij, pavarësisht nëse janë ndërmarrë nga vetë përdoruesi apo nga një palë e tretë. Përdoruesi angazhohet të respektojë të gjitha kërkesat ligjore dhe të përmbahet nga krijimi, shpërndarja apo ngarkimi i përmbajtjeve të ndaluara nga ligji, ose që mund të konsiderohen të papërshtatshme, fyese apo në kundërshtim me etikën institucionale. Çdo

veprim i ndërmarrë brenda ose në lidhje me Portalin e Zhvilluesve të BKT-së duhet të jetë në përputhje me Kodin e Sjelljes dhe Etikës së BKT-së dhe aktet e tjera përkatëse të brendshme.

Ndalohet rreptësisht që përdoruesi të kryejë, apo të angazhohet në, aktivitetet e mëposhtme:

- a) Të përpiqet të analizojë kodin e platformës së zhvilluesve të BKT-së duke përdorur metoda si dekompilimi, rindërtimi i strukturës së brendshme të kodit apo çfarëdo teknike tjetër që synon të zbulojë ose ndryshojë funksionimin teknik të API-ve, të dhënave të testimit apo çdo materiali tjetër të ofruar nga BKT në kuadër të këtij portali;
- b) të përpiqet të ketë akses të paautorizuar në sistemet apo shërbimet e BKT-së ose të përdorë ato në mënyrë të paautorizuar;
- c) të dëmtojë, ndërpresë apo të ndikojë negativisht në funksionimin e sistemeve apo shërbimeve të BKT-së;
- d) të kryejë veprime që pengojnë përdorues të tjerë të përdorin përmbajtjen e BKT-së;
- e) të përdorë robotë ose ndonjë aplikacion të automatizuar për të kërkuar, kopjuar apo indeksuar Përmbajtjen e BKT-së;
- f) të mbledhë të dhëna ose informacion mbi përdorues të tjerë të Portalit të Zhvilluesve;
- g) të prezantojë viruse, kode të dëmshme ose elementë të tjerë keqdashës në sistemet e BKT-së.

Çdo shkelje e këtyre rregullave mund të rezultojë në ndërprerjen e menjëhershme të aksesit, fshirjen e përdoruesit nga sistemi, si dhe marrjen e masave ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Të gjitha kërkesat e API-ve drejtuar infrastrukturës së Open Banking të BKT-së kalojnë nëpërmjet një protokolli të sigurt autentifikimi dhe autorizimi bazuar në OAuth 2.0, ku çdo thirrje është e lidhur me një token të vlefshëm, të krijuar nëpërmjet një procesi identifikimi me shumë faktorë (2FA).

BKT garanton sigurinë dhe integritetin e të dhënave të klientëve në përputhje me rregulloren e mbrojtjes së të dhënave personale, duke siguruar që çdo përpunim të kryhet vetëm në bazë të një pëlqimi të vlefshëm dhe për qëllime të përcaktuara dhe proporcionale.

BKT deklaron se ka marrë masa për të siguruar që ndërfaqja e dedikuar API të ofrojë në çdo kohë të njëjtin nivel disponueshmërie dhe, në rastet kur ndërfaqja nuk funksionon sipas pritshmërive, do të informojë aplikuesin mbi opsionet alternative për rikuperimin e shërbimit.

BKT nuk mban përgjegjësi për vonesat në ekzekutimin e urdhrit të pagesës që burojnë nga gabime teknike apo përdorim i papërshtatshëm i ndërfaqes apo sistemeve nga ana e aplikuesit. Në rast incidentesh, aplikuesi duhet të njoftojë menjëherë bankën për çështjen.

Palët e treta që aksesojnë këtë shërbim nuk kanë të drejtë të ruajnë, përdorin ose përpunojnë të dhënat përtej kohëzgjatjes së autorizuar nga klienti, dhe çdo tejkalim i kësaj periudhe përbën shkelje të termave dhe sjell ndërprerjen e menjëhershme të aksesit.

Përdorimi i shërbimit Open Banking nuk përjashton apo kufizon të drejtën e BKT-së për të pezulluar, kufizuar ose ndërprerë përkohësisht aksesin në rastet kur dyshohet për përdorim abuziv, rrezik sigurie, shkelje të kushteve të marrëveshjes, apo urdhër nga autoritetet kompetente.

TPP-të dhe përdoruesit pranojnë që të gjitha veprimet e ndërmarra përmes platformës së Open Banking janë të regjistruara në log-e të sigurta, dhe mund të përdoren nga BKT për qëllime verifikimi, auditimi, apo përmbushjeje të detyrimeve ligjore.

Aplikuesi deklaron se do të jetë përgjegjës për çdo dëm financiar apo reputacional që i shkaktohet bankës si pasojë e veprimeve ose neglizhencës së tij.

Aplikuesi pranon që çdo mbështetje apo shërbim nga ana e bankës që nuk përfshihet në dokumentacionin e ndërfaqes API ose që nuk kërkohet nga kuadri rregullator mund të jetë subjekt i tarifave përkatëse.

Aplikuesi deklaron se nuk do të përdorë asnjë nga të dhënat e transferuara apo të përpunuara përmes ndërfaqes API për qëllime të tjera, përveç atyre të ofrimit të shërbimeve të pagesave.

Aplikuesi pranon dhe deklaron se do të informojë menjëherë bankën në rast të ndonjë incidenti të sigurisë kibernetike që prek sistemet apo platformat e tij dhe që mund të përbëjë rrezik edhe për ndërfaqen API, dhe do të jetë përgjegjës për kompensimin e bankës në rast të mospërmbushjes së detyrimeve të parashikuara në këtë paragraf.

Aplikuesi pranon që banka ka të drejtë të bllokojë aksesin në ndërfaqen API ose të pezullojë apo anulojë një kërkesë për akses në çdo moment, nëse identifikohet rrezik për mashtrim, akses të paautorizuar apo çështje të sigurisë kibernetike nga ana e bankës.

Ky dokument mund të ndryshohet nga BKT në çdo kohë, me njoftim paraprak dhe publikim të versionit të përditësuar në portalin zhvillues apo faqen zyrtare të bankës. Vazhdueshmëria në përdorimin e shërbimit pas hyrjes në fuqi të versionit të ri të termave nënkupton pranimin e tyre të plotë.

Çdo mosmarrëveshje që lind nga zbatimi i këtyre termave dhe kushteve do të zgjidhet fillimisht në mënyrë miqësore; në të kundërtën, ajo i nënshtrohet juridiksionit të gjykatave shqiptare, me zbatim të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Ndërveprimi në kuadër të përdorimit të Portalit të Zhvilluesve

Portali i Zhvilluesve synon të krijojë një kanal ndërveprimi me qëllim vlerësimin dhe verifikimin e arsyeve për të cilat kërkohet akses në funksione të caktuara të platformës, si dhe për të përmirësuar vazhdimisht përvojën e simulimit në funksion të zhvillimit të API-ve apo integriteteve të tjera teknike. BKT rezervon të drejtën të kontaktojë me ju mbi bazën e të dhënave të deklaruara gjatë regjistrimit, për qëllime të mbikëqyrjes teknike, optimizimit të platformës dhe menaxhimit të përdorimit të portalit.

Përgjegjësitë Kryesore – Ofruesi i Palës së Tretë (TPP)

- TPP-ja është përgjegjëse për saktësinë dhe integritetin e të gjitha udhëzimeve të pagesave dhe të dhënave të klientit të paraqitura në BKT Albania përmes API-së së Open Banking. Kjo përfshin të dhënat e llogarisë së përfutjesit, referencat e pagesës dhe çdo të dhënë të lidhur me transaksionin.
- TPP-ja duhet të sigurojë që platforma e saj të jetë në përputhje me standardet përkatëse rregullatore dhe teknike, përfshirë ato të përcaktuara në PSD2, Ligjin nr. 55/2020 dhe çdo detyrim sigurie të përshkruar në Termat dhe Kushtet e Portalit të Zhvilluesit të BKT-së.

- Çdo gabim që buron nga aplikacioni i TPP-së — si nxitja e dyfishtë e pagesave, trajtimi i pasaktë i pëlqimit të klientit, ose drejtimi i gabuar i parametrave të pagesës — është përgjegjësi ekskluzive e TPP-së.
- TPP-ja pritët të mbajë mekanizma monitorimi dhe mjete regjistrimi në kohë reale për të zbuluar transaksione të dështuara, për të kapur anomali nga ana e klientit dhe për të lehtësuar zgjidhjen e problemeve në bashkëpunim me ekipet teknike të BKT Albania.
- TPP-ja është përgjegjëse për sigurimin që mjedisi që shfaqet për klientin (p.sh. ndërfaqja celulare/web) paraqet informacion të saktë dhe të plotë përpara konfirmimit të transaksionit, dhe që të gjitha pëlqimet e përdoruesit të jenë regjistruar në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.

Përfundimi i Regjistrimit Tuaj

Banka Kombëtare Tregtare rezervon të drejtën të përfundojë regjistrimin tuaj dhe aksesin në Portalin e Zhvilluesve dhe përmbajtjen përkatëse në çdo kohë, pa qenë e detyruar të japë njoftim paraprak. Regjistrimi juaj do të përfundojë automatikisht nëse shkelni ndonjë nga këto Terma dhe Kushte. Me përfundimin e regjistrimit, të gjitha të drejtat që ju janë dhënë në bazë të këtij dokumenti do të hiqen automatikisht.

Për çdo çështje gjatë përdorimit të shërbimit, përdoruesi ose aplikuesi mund të kontaktojë BKT-në në adresat e emailit: openbanking@bkt.com.al ose applicationsupport@bkt.com.al.